

AKT THEMELIMI PËR SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SOFIR ALBANIA" SH.P.K.

KAPITULLI I.

THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT

Neni 1

Themelimi, Forma dhe Ortakët

Sot me datë 23.10.2024 unë themeluesi Ali Rustani, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "SOFIR ALBANIA" SH.P.K.

Themeluesi i shoqërisë është:

- **Ali Rustani**, shtetas shqiptar, lindur në Gosë, më 08.07.1967, mbajtës i kartës së identitetit nr. G70708161P.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Prodhimi i energjise elektrike nëpërmjet burimeve hidro, termike, të erës, fotovoltaike dhe çdo formë tjetër të ngjashme të energjisë së rinovueshme;
- Shitja, shpërndarja e energjisë së prodhuar, pa limit brenda ose jashtë vendit dhe/ose ndaj subjekteve publike ose private, në përputhje me lejen e marrë nga organet shtetërore;
- Studimi, projektimi, ndërtimi i impianteve të mësipërme në çdo fazë të tij, me burimet e veta ose duke nënkontraktuar palë të treta për këtë qëllim, shitja, blerja, transporti, montimi dhe projektimi i makinerive, impianteve, linjave të shpërndarjes dhe/ose pajisjeve dhe pjesëve rezervë të nevojshme për prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar.
- Shitja, blerja, dhënia me qira ose në forma të tjera, përdorimi i pasurive të paluajtshme të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë;
- Pjesëmarrja në shoqëri të tjera dhe dhënia e ndihmës palëve të treta në lidhje me prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Neni 3

Objekti i Shoqërisë

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

Neni 4

Selia.

4.1 Selia e Shoqërisë është Rrugën Asim Vokshi, P33, Hyrja 3, Njësia Administrative nr. 9, Tiranë, Shqipëri.

4.2 Transferimi i Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

4.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë.

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar.

5.2 Shoqëria mund të prishet ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TE KAPITALIT.

Neni 6

Kapitali themeltar.

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.000.000 (një milion) lekë.

6.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues është Ali Rustani: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (një milion) Lekë që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Neni 7

Derdhja Kapitalit

Derdhja e kapitalit do te kryhet pas rregjistrimit te Shoqerise ne rregjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktivitetit te Shoqerise.

Neni 8.

Rritja e kapitalit themeltar.

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 9- Zvogëlimi i kapitalit themeltar.

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufitë e parashikuar nga ligji.

Neni 10- Transferimi i kuotave të kapitalit

10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjërë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë ti afrohen për parablerje ortakëve të tjerë.

10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigjje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetin, emërin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet ti referohet të gjithë kuotës së parashikuar për shitje.

10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për të komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jotë drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk ipërgjigjen në afatin e caktuar, presupozohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon atë, do të ndahet ndërmjet ortakëve pranues, në të njëjtën mase me vlerën nominale të kuotës të kapitalit që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marveshje të kundërt. Në asnjë rast pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.



10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'i ofrohen të tretëve plotësisht ose pjesërisht, me vendim pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie mortis causa ortakët kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të thjeshtë.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABËL.

Neni 11

Asambleja e ortakëve.

11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2 Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese:

- Ndryshimet e statutit
- Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe likuidatorëve
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar
- Transferimin e kuotave
- Shpërndarjen e fitimit
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë
- Miratimin e bilanceve

Dhe çdo vendim tjetër të përcaktuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.


Neni 12

E drejta e pjesmarrjes dhe e votes

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marri pjesë në Asamble, të paraqesë mendimet e tij dhe të japë aq vota në propocion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ai zotëron.

12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e të cilës mund të japë votën e tij.


12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.



Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, kuorumi dhe Vendimet

- 13.1** Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve kalendarike nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe të inventarit.
- 13.2** Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe një ose disa ortakëve që zotërojnë të paktën 5% (pesëpërqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigjie që duhet t'u dërgohet ortakëve, në adresën që rezulton sipas këtij Statuti, dhe ekspertit kontabël (në se është emeruar), të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3** Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.
- 13.4** Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesë të kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh po me të njëjtin rend dite.
- 13.5** Mbledhjet e Asamblesë mund të bëhen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet dhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6** Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7** Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për të cilat kërkohet një shumicë e



thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 71% (shtatëdhjetënjë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për të cilat kërkohet një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 85% (tetëdhjetëpesë përqind) të kapitalit themeltar.


- 13.8** Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statitit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë me më shumë se 85% (tetëdhjetëpesë përqind) të votës së ortakëve.
- 13.9** Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose nga një person i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar jo domozdoshmërisht ortak.
- 13.10** Vendimet e asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 **Administrimi**

- 14.1** Shoqeria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkimin apo dorëheqjen për një periudhë prej 3 (tre) vitesh. Administratori do të emërohet nga Ortaku i Vetëm.
- 14.2** Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në Nenin 95 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, përveç sa parashikohet në nenin 14.3 në vijim.
- 14.3** Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh

Neni 15 **Eksperti kontabel i autorizuar**

- 15.1** Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe i librave kontabël të Shoqërisë mund ti besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2** Ekspertët kontabël të autorizuar mund të shkarkohen në cdo kohë sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIIMEVE

Neni 16

Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1** Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron në 31 dhjetor të sejcilit vit.
- 16.2** Viti I parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 16.4** Miratimi I dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhen brënda 120 (njëqinde njëzet) ditëve që nga fundi I vitit financiar.

Neni 17

Fitimet

- 17.1** Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në propocion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit themeltar të zotëruar.
- 17.2** Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonëshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhëshme.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja

- 18.1** Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar në Statut, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anën e një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në Statut.
- 18.2** Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.



Neni 19

Likuidimi

- 19.1** Në rast prishje Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2** Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3** Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e priçesit të likuidimit.
- 19.4** Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit të ortakëve, në propocion me vlerën nominale të kuotës së zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1** Të gjitha mosmarveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi ndërmjet ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shqipërisë) ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2** Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.




Neni 21
Gjuha

Ky Statut është hartuar në ... kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

ALI RUSTANI

Handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Ali Rustani', with a horizontal line underneath the name and a large, stylized flourish below it.